



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

DREJTORIA JURIDIKE DHE PËRPUTHSHMËRISË SË STANDARTEVE

Nr. 11034/prot.
12

Tiranë, më 11.12.2018

Lënda: Kallëzim penal

PROKURORISË PRANË GJTYKATËS SË RRETHIT GJYQESOR TIRANË

ME OBJEKT : Kallëzim i veprave penale “Fallsifikim dokumentash” dhe “Mashttrim”, parashikuar përkatësisht nga neni 186 dhe 143 i Kodit Penal i RSH.

KUNDËRR : Kompanisë “DH Albania”

BAZA LIGJORE : Neni 186 dhe 143 i Kodit Penal, Nent 280 dhe 283 te Kodit të Procedures Penale.

I/E nderuar z/znj prokuror/e,

Bazuar në nenet 186 dhe 143 të Kodit Penal dhe nenet 280 dhe 283 të Kodit të Procedures Penale, po ju parashtröjmë këtë kallëzim penal për veprën penale të sipërcituar.

Ju bëjmë me dije se kompania “DH Albania,” e cila ka lidhur nje kontratë me ARrsh-në me objekt “Rehabilitimin e segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja, Loti 1”, ne kushtet e mashtrimit, ka paraqitur dokumente te rreme ne lidhje me të dhënat e shoqërisë mëmë Dunwell Haberman në SHBA, si aktin e themelimit dorezuar në QKB shqiptare ku pretendon se është themeluar në 25 qershor 1998, kur në fakt ne na rezulton se data reale është 25 qershor i 2018 si dhe dokumente te tjera, referuar shkresës së ardhur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nr.14700/1 prot., dt.11.12.2018. Pra, institucioni jonë gjendet në kushtet e mashtrimit dhe fallsifikimit të qartë të dokumentave,veprime me rrezikshmëri dhe qe dëmtojnë rëndë imazhin e institucionit tonë dhe buxhetin e shtetit.

Ndodhur ne këto kushte, kërköjmë nga ana juaj në bazë të autoritetit që ju jep ligji , një hetim të gjithanshëm dhe të plotë në lidhje me keto fakte dhe vënien e kompanisë në fjalë dhe personave përgjegjës përballë përgjegjësisë ligjore.

Bashkëlidhur kallëzimit keni dhe shkresat që provöjnë ato cka ju parashtröam.

DREJTORI I PËRGJITHSHEM
Afrim Qendro

